

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Elbasan dhe Kamëz për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:** Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, P. Doçaj
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita atëherë, kemi në rendin e ditës këto projektvendime atë për shpërndarjen e mandateve, për anëtarë të këshillit për këshillin e Bashkisë Elbasan, për këshillin e bashkisë Kamëz, për dhënien e mandatit për kryetarë të Bashkisë Belsh, Elbasan dhe Kamëz, si edhe projektvendimin për caktimin e datës për përsëritjen e zgjedhjeve për kryetarë të Bashkisë Rogozhinë, por të cilin do ta shtyj pasi nuk ka përfunduar akoma shqyrtimi i ankimit në Kolegjin Zgjedhor për Bashkinë e Kuçovës, edhe ky vendim do të duhet të merret pasi të përfundojnë shqyrtimin i të gjithë ankimit në Kolegjin Zgjedhor. Atëherë vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit, bazuar në nenin 19, pika “i” të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si edhe jep mandate për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është i ndarë në më shumë se 1 KZAZ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.06.2023*

ka miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit për Këshillin e Bashkisë Kamëz dhe Elbasan, edhe kundër këtij vendimi është bërë ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili në përfundim të shqyrtimit administrativ ka vendosur për Bashkinë Kamëz rëzimin e kërkesës ankimore numër 81, pranimin e kërkesës 86 duke lëshuar vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke futur tabelat pas numërimit të Bashkisë Kamëz për këshillin e bashkisë, gjithashtu kundër ankimit të vendimit të Komisionerit për tabelën e Këshillit të Elbasanit është bërë ankim në KAS i cili ka vendosur rëzimin e kërkesës ankimore për Këshillin e Bashkisë Elbasan, kundër këtyre vendimeve të KAS-it është bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor i cili në të dy rastet ka vendosur rëzimin e kërkes-padisë paraqitur nga ankuesi. Në bazë të nenit 162 pika 1 dhe 160 pika 3 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përlllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore në bazë të numrit të votave të vlefshme për çdo subjekt zgjedhor, si dhe bënë renditjen e tyre në tabelën përkatëse. Në këto kushte referuar nenit 163 dhe 166 të Kodit Zgjedhor i kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e shpërndarjes së mandatit subjektivit zgjedhor për këshillin e Bashkisë Kamëz dhe Elbasan, sipas tabelës që është miratuar nga Komisioneri, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, atëherë shpërndarja e mandateve për Bashkinë e Elbasanit ndërmjet subjekteve zgjedhore është si më poshtë:

Koalicioni Bashkë Fitojmë ka 12 mandate për anëtarë këshilli në Bashkinë e Elbasanit.

Partia Socialiste e Shqipërisë 28.

Partia Demokracia Sociale ka 1.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.06.2023*

Partia Socialdemokrate 1.

Partia Demokratike 7.

Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet 1.

Partia e Gjellbër 1.

Për Këshillin e Bashkisë Kamëz shpërndarja e vendeve në këshill është si vijon:

Koalicioni Bashkë Fitojmë 11 mandate.

Partia Socialiste e Shqipërisë 19.

Partia Agrare Ambientaliste 1.

Partia Republikane 1.

Partia Lëvizja e Legalitetit 1.

Aleanca Liberale Djathtë 1.


Partia Socialdemokrate 2.

Partia Demokratike 3.

Fryma e Re Demokratike 2.

Vendimi nr. 668, 669

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.06.2023*

**26.06.2023
Ora 14:33**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, Belsh Kamëz, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:** Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, P. Doçaj
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pretendimet që lidhen me dhënien e mandateve për kryetarë të bashkisë .

Z. Y. Merkaj: Faleminderit, bazuar në nenin 166 pika 1 e Kodit Zgjedhor, kryetarë bashkie zgjidhet kandidati i cili ka fituar në mënyrë më të madhe të votave të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse. Bazuar në nenin 33 shkronja “g” të Kodit Zgjedhor, Komisioni i zonës së administrimit zgjedhor të Bashkisë Belsh ka shpallur fitues kryetarin e bashkisë propozuar nga Partia Socialiste, gjithashtu KQZ-ja ka shpallur fitues për Bashkinë Kamëz zotin Rakip Suli dhe për Bashkinë Elbasan zotin Gledian Llatja, kundër këtyre vendimeve është bërë ankim në Kolegjin, Zgjedhor. Ndërkohë KAS-i, ka lënë në fuqi vendimin e Komisionerit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit dhënien e mandatit për kryetarë Bashkie të Elbasanit, Kamzës dhe të Belshit, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.06.2023*

Z. I. Celibashi: Atëherë vendosim dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Belsh, Qarku Elbasan zotit Arif Tafani propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë;

Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Elbasan zotit Gledian Llatja propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë;

Dhënien e mandatit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë zotit Rakip Suli, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Çështje të tjera nuk kemi seanca mbyllet.

Vendimi nr. 670, 671, 672

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

